



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALLAKASTËR

Nr. 2691 / Prot.

Ballsh, më 23.06.2025

PROCESVERBAL

Dëgjesa Publike me Banorët për Programin Buxhetor Afatmesëm 2026–2028

Më datë **23.06.2025**, në qytetin e Ballshit, në ambientet e Pallatit të Kulturës “Dino Kalenja”, u zhvillua dëgjesa publike me temë: **“Hartimi i dokumentit të parë të Programit Buxhetor Afatmesëm 2026–2028 dhe Planit Vendor për Emergjencat Civile.”**

Dëgjesa u hap nga Kryetari i Këshillit Bashkiak, **z. Nexhmi Sulaj**, i cili informoi qytetarët se mendimet dhe sugjerimet e tyre do të merren parasysh dhe do të reflektohen në draftin përfundimtar të dokumentit. Ai falënderoi të gjithë pjesëmarrësit për angazhimin e tyre.

Prezantimi i Programit Buxhetor Afatmesëm u bë nga **z. Aleksandër Rama**, i cili u shpreh:

“Kjo është faza e parë e këtij programi. Po ju paraqesim parashikimet e bashkisë në lidhje me shpenzimet, investimet, të ardhurat dhe elementë të tjerë të rëndësishëm.”

Parashikimet Kryesore të Bashkisë Mallakastër për vitet 2026–2028

◆ **Politika e investimeve dhe kursimeve:**

- Ulje e shpenzimeve për pagat e personelit.
- Rritje e investimeve në infrastrukturë.

Investimet e planifikuara përfshijnë:

- Rikonstrukcionin e rrugës së Ribanit
- Rikonstrukcionin e rrugës së Gadurovës
- Rikonstrukcionin e rrugës së Kremenarit

Investime të përfunduara deri më tani:

- Rrugët e Greshicës, Mollajt dhe Metohut

Struktura e Programit Buxhetor Afatmesëm

Të ardhurat (2026–2028):

1. Të ardhura nga burimet e veta
2. Transferta të pakushtëzuara të përgjithshme
3. Transferta sektoriale
4. Të ardhura nga taksat e ndara
5. Të ardhura të mbartura nga viti i kaluar

Shpenzimet (2025–2028):

1. Shpenzime për personelin
2. Shpenzime korrente
3. Shpenzime kapitale

Shpenzimet janë parashikuar të rriten me **3% çdo vit**, me fokus në:

- Rikonstruksion të rrugëve që lidhin fshatrat me rrugët nacionale
- Përfundimin e segmenteve rrugore të papërfunduara në Njësitë Administrative **Fratar dhe Kutë**
- Rikonstruksionin e shkollës “Ismail Klosi” në Ballsh
- Mbrojtjen e tokave bujqësore në fshatin Corrush nga lumi Vjosa

Fushat me prioritet të lartë:

- Përmirësimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit
- Rehabilitimi i rezervuarëve dhe digave
- Shërbimet publike (p.sh., mirëmbajtja e varrezave)
- Arsimi parashkollor dhe i mesëm

Dokumentacioni i plotë është publikuar mbi 20 ditë përpara dëgjësës në faqen zyrtare të Bashkisë dhe të Këshillit Bashkiak.

Linku i publikimit:

https://www.bashkiamallakaster.gov.al/sites/default/files/Tabelat%20e%20PBA%202026-2028%20-%20Faza%201%20-%20131%20-%20Bashkia%20Mallakast%C3%ABr%20-%202027_05_25.pdf

Rekomandimet e qytetarëve

- **Z. Rrapo Asllanaj:**
 1. Kërkoji fond për ujitjen e tokave bujqësore në zonën Rromës-Hekal.
 2. Pyeti për materialin e përdorur në rikonstruksionin e rrugëve (çakull apo asfalt).
- **Z. Erton Isufaj:**

Përgjigje – Z. Rama: Rikonstruksioni po kryhet me asfalt-beton.

- Kërkoj që mirëmbajtja e qendrave shëndetësore të mbulohet nga pushteti vendor përmes granteve specifike, njësoj si çerdhet dhe kopshtet.
- **Z. Brahim Hoxhaj:**
 - Shtroi nevojën për rikonstruksionin e rrugës Ballsh–Rromës, pasi është një lidhje direkte me Vlorën dhe shmang nevojën për devijime në Hekal apo Fratar.
- **Z. Ali Shametaj:**
 - 0. Nevojë për ndërtimin e tualeteve publike
 - 1. Hapje rrugësh nëpër tokat bujqësore

Përgjigje – Z. Rama: Po realizohen procedurat për blerjen e një buldozeri për hapjen e rrugëve bujqësore.
- **Z. Arlind Myselaj:**
 - 1. Ankesa për qen endacakë në lagjen Bylis
 - 2. Rrëshqitje e qytetarëve në shtrimin e bërë keq pranë kioskës së gazetave

Përgjigje – Znj. Armela Malaj: Problem i njohur dhe në proces zgjidhjeje.
- **Znj. Enkeleda Hyskaj:**
 - Kërkoj fond për ndërtimin e një tualeti, çezme dhe rrethimi në parkun e liqenit, si dhe vënie në dispozicion të një roje për ruajtjen e ambientit.

Plani Vendor për Emergjencat Civile (PVEC) – Prezantuar nga Z. Izet Ymeraj

Në përputhje me ligjin nr. 45/2019 "Për Mbrojtjen Civile" dhe dokumentet strategjike në vijim:

- Strategjia Vendore për Zvogëlimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë
- Vlerësimi i Riskut dhe Cënueshmërisë në nivel vendor

PVEC i Bashkisë Mallakastër ka për qëllim:

- Mbrojtjen e jetës dhe mirëqenies së qytetarëve gjatë emergjencave
- Minimizimin e dëmeve në pronë, infrastrukturë, trashëgimi kulturore dhe mjedis
- Rritjen e kapaciteteve të komunitetit për përballimin e fatkeqësive

Objektivat kryesore të PVEC përfshijnë:

- Evakuimi në kohë dhe ndihma mjekësore
- Vlerësimi dhe identifikimi i riskut
- Rritja e ndërgjegjësimit publik
- Bashkëpunimi ndërinstitucional
- Informimi dhe komunikimi i qartë me publikun në çdo fazë të emergjencës

PVEC është i harmonizuar me **Kuadrin Sendai për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë Natyrore**.

Komisioni i Mbrojtjes Civile, i ngritur në nivel vendor, drejtohet nga kryetari i bashkisë dhe përfshin drejtues të institucioneve lokale (polici, arsim, shëndetësi, etj.). Ky komision është një strukturë e përhershme dhe reaguese ndaj çdo situatë emergjente.

Në përfundim, z. Nexhmi Sulaj falënderoi të gjithë qytetarët për pjesëmarrjen dhe theksoi se të gjitha sugjerimet do të shqyrtohen dhe, sipas mundësive financiare dhe prioriteteve, do të përfshihen në fazat e ardhshme të Programit Buxhetor Afatmesëm.

Faleminderit për pjesëmarrjen dhe kontributin!

MBAJTËS TE PROCESVERBALI

KOORDINATORI PËR NJOFTIMIN DHE

SEKRETARE E KESHILLIT BASHKIAK

KOSULTIMIN ME PUBLIKIKUN

Zinaida Ahmetaj

Rovena Osmënaj

